



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:095461
Datë: 19.03.2025
Numri i dokumentit: 07012178

AA.nr.337/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar i kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit, B.L, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Sherif Sherifi, avokat nga Vitia, kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.813/2023, të datës 28.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.03.2025, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, B.L, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.813/2023, i datës 28.02.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.813/2023, të datës 28.02.2024, është vendosur, “*I. REFUZOHET padia dhe kërkesëpadia e B.L, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sherif Sherifi, avokat nga Vitia, me të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës (KPMŠHCK), A.Nr.406/2023 i datës 04.04.2023, si e pabazuar. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.*”

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka ushtruar ankesë përmes të autorizuarit të tij, me të cilin konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes qenësore të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa e paditësit dhe aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet dhe të vendos në favor të paditësit, apo të njëjtin anulohet dhe lëndën t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe në rivendosje.

I padituri, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe ka gjetur se ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar, A.Nr.406/2023 të datës 04.04.2023, i padituri, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit B.L me numër A.nr.406/2023 të datës 23.02.2023.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK), ka ushtruar padi për konflikt administrativ më datë 25.04.2023, me të cilën ka kërkuar të aprovohet padia si të bazuar dhe të anulohet vendimi i kundërshtuar të paditurit, KPMSHCK dhe tia njohë kompensimin e pagave në mënyrë retroaktive nga data 01.12.2011 deri më datë 30.10.2022 me kamatë ligjore prej 8%.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të paditurës, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në padi, në përputhje me nenin 44 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar. Gjykata gjeti se vendimi i atakuar i marrë nga i padituri është në përputhje të plotë me nenin 127, paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, i cili përcakton: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”. Me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar me padi, gjykata ju referua nenit 4, paragrafit 1 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave i cili përcakton se “Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkëlqje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës, nenit 8 parag.2 Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”. Gjykata pasi administroi provat si me lart dhe vlerësuar në drejtim të pretendimeve të paditësit, konstatoi se vendimi i të paditurës është i drejtë dhe i ligjshëm dhe po ashtu i bazuar në prova, nga të cilat prova është i mbështetur edhe vetë akti administrativ tani i atakuar me padi. Në këtë kuptim gjykata vlerësoi se meqë paditësja as me padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ka dëshmuar se i njëjti ka paraqitur ankesë brenda afatit ligjor prekluziv, prandaj për këto arsye padia dhe kërkesëpadija u refuzoi si e pabazuar. Prandaj Gjykata vlerësoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, të paditurit drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës së përgjithshme administrative dhe të ligjit material, kur kanë marrë vendimin e kontestuar nga paditësja. Mbi këto arsye thënie të paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.”*

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditësi të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktësisht se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të procedurës, megjithatë kolegji i apelit vëren se gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se paditësi në ankesë edhe kësaj shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi jo i drejtë e gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike kur ka nxjerrë përfundim se *“Me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar me padi, gjykata ju referua nenit 4, paragrafit 1 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave i cili përcakton se “Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë më marrëdhënien e tyre të punës, nenit 8 parag.2 Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”. Gjykata pasi administroi provat si me lart dhe vlerësuar në drejtim të pretendimeve të paditësit, konstatoi se vendimi i të paditurës është i drejtë dhe i ligjshëm dhe po ashtu i bazuar në prova, nga të cilat prova është i mbështetur edhe vetë akti administrativ tani i atakuar me padi. Në këtë kuptim gjykata vlerësoi se meqë paditësja as me padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ka dëshmuar se i njëjti ka paraqitur ankesë brenda afatit ligjor prekluziv, prandaj për këto arsye padia dhe kërkesëpadia u refuzoi si e pabazuar.”*

Gjithashtu kolegji i apelit vëren se paditësi më datë 02.12.2011, ka nënshkruar akt emërimit me Komunën e Vitisë për vendin e Punës “Zyrtar i Lartë i Personelit” me koeficient të pagës 8, ndërsa ka realizuar koeficient të pagës 7.5, dhe se i njëjti nuk ka ndërmarre asnjë veprim për realizimin-ekzekutimin e koeficientit sipas akt emërimit deri me datë 26.09.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 130 të Ligjit për Procedurën Administrative, i cili përcakton se *“Ankimimi Administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.”* Po ashtu paditësi ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili nen përcakton se *“2. Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës.”* Kurse neni 4 paragrafi 1, i të njëjtës rregullore përcakton se *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë më marrëdhënien e tyre të punës.”*

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, pasi që paditësi me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e saj ankimore, ndërsa provat e propozuara si prova të bashkangjitura me shkresat e lëndës nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit gjendja e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar i

gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale, gjithashtu aktgjykimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale, dhe mbi këtë bazë ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.337/2024, datë 12.03.2025

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti